



KOMUNA E LIPJANIT

RAPORT

- Shqyrtimin e Projekt-Statutit të Komunës

RAPORT

- Shqyrtimin e Projekt-Statutit të Komunës

Të pranishëm nga zyrtarët komunalë janë:

1. Vlora Krasniqi, Shefe e Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore
2. Rafete Rekoceri, Nëpunëse për çështje juridike
3. Islam Kaleshi, Zyrtar Ligjor

Debatin publik e hapi Vlora Krasniqi, , Shefe e Sektorit për përfaqësim dhe çështje ligjore e cila prezentoj draftin e Projekt Statutit të Komunës së Lipjanit i cili është në fazën e konsultimit me publikun dhe pritët të miratohet në seancën e radhës të Kuvendit të Komunës dhe kërkoi nga të pranishmit që të japin vërejtjet dhe komentet e tyre rreth këtij drafri pasi ata e kanë mundësinë që të japin propozime konkrete

Behar Krasniqi, Zyrtar i lartë ligjor kërkoi sqarime rreth detyrave dhe përgjegjësi të sektorëve në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Komunës si dhe te disa nene që Zyra e Avokatit Publik komunal ka dërguar komentet me shkrim.

Vlora Krasniqi, Kryesuese e Komisionit i njoftoj të pranishmit se ndryshimet e Statutit po bëhen me qëllim të harmonizimit me dispozitat e legjislacionit në fuqi kryesisht Ligjit për kufijtë administrativ komunal ku disa 8 vendbanime kanë kaluar me Komunën e

Gračanicës si dhe disa ndryshime dhe plotësime të struktura e brendshme organizative e disa drejtorateve komunale ku dy Drejtorate Komunale kanë ndryshuar emërtimin e tyre ndërsa numri I drejtorateve mbetet I njëjtë .Drejtoratet që marin emërtimin e ri janë Drejtorati për Shërbime publike , mbrojtje dhe shpëtim dhe Drejtorati për Infrastrukturë.

Qytetarët tjerë të pranishëm nuk patën ndonjë vërejtje apo kërkesë për ndryshim ose plotësim të ndonjë neni konkret të Projekt-Statut dhe u mbyll takimi.

Njoftimi është publikuar me 02.12.2021, në web faqen e komunës dhe facebook-un zyrtar, linku: <https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2021/12/NJOFTIM-PER-DEBAT-PUBLIK-PROJEKT-STATUTi.pdf>





Procesverbal nga takimi: <https://kk.rks-gov.net/lipjan/wp-content/uploads/sites/20/2021/12/procesverbal.pdf>